



IOM International Organization for Migration

Ndihmë për Kthimin e Vullnetshëm të Migruesve të Parregullt (AVRIM)

Pyetje që bëhen shpesh (FAQs)

1. Çfarë është programi i Ndhmës për Kthimin e Vullnetshëm të Migruesve të Parregullt (Assisted Voluntary Return for Irregular Migrants ose AVRIM në anglishte)?

IOM ofrohet të ndihmojë migrues të parregullt që dëshirojnë të kthehen përfundimisht në vendet nga kanë ardhur. Programi AVRIM është i hapur ndaj të gjithë atyre që:

- janë sjellë në mënyrë të paligjshme ose trafikuar në Mbretërinë e Bashkuar
- kanë qëndruar përtej afatit të vizave
- nuk kanë të drejta ligjore për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar.

2. Si funksionon programi AVRIM? Çfarë procedurash ndiqen?

AVRIM bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian dhe Ministria e Brendshme Britanike. Ministria e Brendshme e këtushme vendos nëse aplikanti për AVRIM i plotëson kushtet për t'u kthyer nëpërmjet programit.

Në krye ju duhet të plotësoni formularin e aplikimit dhe të nënshkruani një deklaratë për kthim të vullnetshëm. Të gjithë personat që kanë mbushur moshën 18 vjeç duhet ta nënshkruajnë formularin vetë.

Nëse keni dokument udhëtimi, duhet të na e jepni neve. Nëse nuk keni dokument udhëtimi, ne do t'ju ndihmojmë që të pajiseni me një të tillë.

Kur të marrim aplikimin prej jush, do t'ia dërgojmë të dhënat Ministrisë së Brendshme dhe do t'i njoftojmë se ju keni aplikuar për t'u kthyer nëpërmjet programit AVRIM. Ministria e Brendshme duhet të japë miratimin e vet për këdo që ka aplikuar të kthehet nëpërmjet programit.

Duhet të vini në zyrat e IOM-it për t'ju marrë shenjat e gishtërinjve, çka është e nevojshme për t'u siguruar se nuk keni kryer ndonjë histori krimesh serioze në Mbretërinë e Bashkuar. Pasi ju të keni vendosur të aplikoni për programin AVRIM, do t'ju njoftojmë për datën se kur duhet të paraqiteni për këtë procedurë të zakonshme.

Paskëtaj do të diskutojmë me ju datën se kur dëshironi të udhëtoni dhe do të fillojmë të përgatitim udhëtimin.

Do të rezervojmë provizorisht një biletë udhëtimi për ju.

Do të sigurojmë edhe vizat tranzit të nevojshme për vendet ku duhet të kaloni, nëse nuk ka fluturim të drejtpërdrejtë për vendin tuaj të origjinës.

Do të takohemi me ju në aeroportin britanik nga ku do të nisni udhëtimin për t'ju ndihmuar me formalitetet e nisjes si dhe do t'ju takojmë kur të mbërrini në destinacion.

3. A mund të ma garantojë IOM anonimitetin?

Të gjithë kërkesat që i vijnë IOM për informacion do të trajtohen me fshehtësi dhe anonimisht.

Emri juaj dhe të dhënat e kontaktit do t'i përcillen Ministrisë së Brendshme vetëm pasi t'ju jetë dhënë në fshehtësi të plotë krejt informacioni për programin dhe pasi ju vetë të keni vendosur të aplikoni për këtë program.

Jeni të lirë të hyni në kontakt me IOM për të marrë të dhëna rreth programit AVRIM, dhe pastaj të vendosni të mos merrni pjesë. Në një rast të tillë, nuk jeni të detyruar t'i jepni IOM-it të dhëna tuajat personale.

Nëse aplikoni për programin AVRIM por nuk keni mundësi të jepni një adresë tuajën, mjafton të na lini një numër telefoni (madje edhe thjesht telefoni celular) ku të mund t'ju thërrasim. Është e rëndësishme që ne gjithnjë të mund të lidhemi me ju gjatë orarit zyrtar normal të IOM-it.

4. Do të më ndjekë penalisht Ministria e Brendshme kur të merret vesh se unë jam këtu pa dokumentet e nevojshme për të qëndruar?

Ministria e Brendshme britanike nuk do të përndjekë askënd që dëshiron të kthehet vullnetarisht në atdhe nëpërmjet programit AVRIM, edhe sikur të ketë pasur shkelje të vogla të ligjit të imigracionit gjatë hyrjes në Mbretërinë e Bashkuar.

5. Ka përkthyes gojorë në zyrat tuaja?

Në zyrat e IOM-it në Londër punojnë njerëz që flasin një numër të madh gjuhësh. Po të jetë e nevojshme, IOM mund të sigurojë përkthyes.

6. Çfarë lloj dokumenti do të më duhet për të udhëtuar?

Në rast se nuk mund të udhëtoni me pasaportën tuaj, do t'ju duhet të pajiseni me një dokument udhëtimi një-rrugësh nga ambasada e vendit tuaj. Përndryshe, disa prej jush do të mund të udhëtojnë me një letër të Bashkimit Evropian. IOM do t'ju tregojë se çfarë dokumentash do t'ju duhen dhe si t'i siguron ato. Ne gjithashtu do të mbulojmë edhe shpenzimet përkatëse.

7. A mund ta vendos unë vetë se kur do të kthehem në atdhe?

Pasi të keni aplikuar për programin AVRIM, do të diskutojmë me ju për të vendosur një datë të përafërt për kthimin, të tillë që t'u përshtatet planeve tuaja. Data e fluturimit gjithnjë varet edhe nga oraret e linjave ajrore dhe nga dokumentet e vlefshme për udhëtim në zotërimin tuaj. Megjithatë, do t'ju kërkohet të udhëtoni brenda tre muajsh.

8. Sa kohë do të duhet për të organizuar udhëtimin tim të kthimit?

IOM gjithnjë synon të plotësojë nevojat e atyre që kthehen, duke kërkuar edhe mënyrën më të përshtatshme të kthimit. Afati i kthimit varet nga faktorë të ndryshëm, të tillë si miratimi nga Ministria e Brendshme, sigurimi i dokumenteve të udhëtimit, oraret e linjave ajrore dhe të tjera kërkesa të posaçme që duhen mbajtur parasysh për udhëtimin e kthimit.

Objektivi i programit të Ndihmës për Kthimin e Vullnetshëm të Migruesve të Parregullt është t'i ndihmojë njerëzit të kthehen në atdhe në mënyrë të rregullt dhe dinjitoze. Kur udhëtoni të asistuar nga IOM, ju do të udhëtoni njëloj sikurse çdo pasagjer tjetër. Arsyet e qëndrimit tuaj në Mbretërinë e Bashkuar dhe të kthimit tuaj në atdhe do të mbeten të fshehta dhe nuk do t'i përcillen askujt.

9. Si do të shkoj në aeroport (në Mbretërinë e Bashkuar)?

IOM do të rezervojë bileta të klasit të dytë (coach) dhe do të paguajë për to. Pasi të keni aplikuar për kthim të vullnetshëm në atdhe dhe aplikimi juaj të jetë pranuar, IOM do të porositë biletën, e cila do t'ju dërgohet brenda 48 orësh, madje edhe 24 orësh nëse këtë e kërkon orari i udhëtimit. Rrini të qetë, bileta **do t'ju mbërrijë** në kohë.

10. Sa bagazh mund të marr me vete?

Kjo varet nga linja ajrore me të cilën fluturoni. Normalisht, ju lejohet të merrni me vete një bagazh jo më të rëndë se 25 kg. Nëse sillni më shumë bagazh, do t'ju duhet të paguani. Bagazhi ekstra kushton shumë. IOM nuk merr përsipër të paguajë për bagazh të tepërt. Ne ju këshillojmë që plaçkën e tepërt ta dërgoni njëfarësoj me postë paraprakisht, sepse kështu do të shpenzoni shumë më pak.

11. Çfarë ndodh kur të arrij në vendin tim të origjinës?

Nëse keni nevojë të ndihmoheni nga IOM në aeroportin e vendit tuaj të origjinës, ne mund t'ju sigurojmë ndihmën e nevojshme.

Nëse ju pret një rrugë e gjatë nga aeroporti deri në destinacionin përfundimtar, ne përsëri mund t'ju ndihmojmë e të paguajmë për këtë pjesë të udhëtimit.

12. A mund të më ofroni ndihmë të mëtejshme kur të jem kthyer në atdhe nëpërmjet programit AVRIM?

Në rrethana normale, programi AVRIM nuk ofron ndonjë lloj Ndihme për Ri-integrim në vendin tuaj. Megjithatë, IOM mund të japë njëfarë Ndihme Ri-integrimi për të mitur të pashoqëruar, viktime të trafikimit dhe persona me probleme shëndetësore. Kjo do të vendoset për çdo rast veç e veç.



Actions co-financed by
Community Funds.